

UDHËZIM
Nr. 12, datë 13.7.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E NIVELEVE MAKSIMALE TË PRANISË SË
KOKSIDIOSTATIKËVE DHE HISTOMONOSTATIKËVE NË QUMËSHT, MËLÇI,
VESHKA, SI DHE USHQIME TË TJERA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka si qëllim dhënien e informacionit mbi përcaktimin e niveleve maksimale të pranisë së koksidiostatikëve dhe histomonostatikëve në produktet ushqimore të listuara në aneksin e udhëzimit.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2.1 Koksidiostatikë janë preparate që kufizojnë përhapjen e koksidgeve në aparatën tretës të shpendëve.

2.2 Histomonostatikë janë preparate që kufizojnë përhapjen e histomonave në aparatën tretës të shpendëve.

3. Ndalohet tregtimi i ushqimeve të cilat janë listuar në shtojcën e këtij udhëzimi nëse ato përmbajnë kontaminantë të renditur në këtë shtojcë në një nivel që tejkalon nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcë.

4. Në rast se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit konstaton mbetje të kontaminantëve nën nivelin maksimal të përcaktuar në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, në këtë rast ai kryen kontrollë për të vërtetuar që mbetja në ushqime është e pranishme si pasojë e bartjes së pashmangshme në ushqim dhe jo si pasojë e administrimit të paligjshëm të koksidiostatikëve dhe histomonostatikëve.

5. Kur zbatohen nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcën e këtij udhëzimi tek produktet ushqimore të thara, të holluara, të përpunuara ose të përbëra nga më shumë se një përbërës, ndryshimet e përqendrimit të ndotësve të shkaktuara nga tharja, hollimi ose përpunimi, do të merret parasysh proporcioni relativ i përbërësve në produkt.

6. Nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcën e këtij udhëzimi, nuk paragjykojnë dispozitat dhe MRL-të e përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 5.10.2010, “Për limitet maksimale të mbetjeve të produkteve mjekësore veterinarë në produktet ushqimore me origjinë shtazore”.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCË
NIVELET MAKSIMALE NË USHQIME

Substanca	Ushqimet	Përmbajtja maksimale në µg/kg(ppb), peshë e lagësht
1. Lasalocidsodium	Ushqim me origjinë shtazore nga lloje të tjera kafshësh përjashtoj shpendët dhe gjedhin: - qumësht - mëlçi - veshka - të tjera	1 50 20

		5
2. Narasin	Ushqime me origjinë nga kafshët e tjera përveç broiler: - vezët - qumësht - mëlçia - të tjera	2 1 50 5
3. Salinomycinsodium	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç zogj dhe lepuj majmërie: - vezët - mëlçia - të tjera ushqime	3 5 2
4. Monensinsodium	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç broiler, gjela deti dhe gjedh (përfshirë këtu lopët e qumështit): - mëlçia - të tjera ushqime	8 2
5. Semduramicin	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç broiler.	2
6. Maduramicin	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç zogave për majmëri dhe gjelave të detit. - vezët	12
7. Robenidinë	Ushqime me origjinë nga kafshët të tjera përveç zogave për majmëri, gjela deti, lepuj për majmëri dhe mbarështim: -vezë -mëlçi, veshka, lëkurë dhe dhjamë. -të tjera ushqime.	25 50 5
8. Decoquinat	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler, gjela deti dhe lepuj për majmëri dhe mbarështim.	20
9. Halofuginon	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler, gjela deti gjedh përveç lopët e qumështit: - vezë - mëlçi dhe veshka - qumësht - të tjera ushqime	6 30 1 3
10. Nicarbazin (mbetja:4,4- dinitrocarbanilide (DNC)	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler: - vezë - qumësht - mëlçi - veshka - të tjera ushqime	300 5 300 100 50
11. Diclazuril	Ushqim me origjinë nga kafshët të tjera përveç broiler, gjela deti për majmëri, lepuj për mbarështim dhe majmëri, ruminantë dhe derra: - vezë - mëlçi dhe veshka - të tjera ushqime.	2 40 5